



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:123695

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06038484

CAP.nr.265/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm -Divizioni Civil, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Z.B nga P...., të cilin e përfaqëson A.L, avokat nga P...., ndaj debitorit Komuna e Prishtinë-Drejtoria e Arsimit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të paraqitur kundër aktvendimit CPC.nr.16/21 i datës 22.06.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me datë 09.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e kreditorit Z.B nga P....., ndërsa aktvendimi CPC.nr.16/21 i datës 22.06.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e ankimuar CPC.nr.16/21 i datës 22.06.2022, ka vendosur që të Refuzohet propozimi për lejimin e përmbarimit i kreditorit, si të pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor, kreditori, ka paraqitur ankesë dhe atë për shkak të shkeljes së drejtës materiale dhe të drejtës procedurale, me propozim Gjykatën e Apelit në Prishtinë, që ta aprovojë ankesën si të bazuar, ndërsa aktvendimin e atakuar ta prishë dhe i njëjti të kthehet në rigjykim dhe rivendosje, ose që të aprovohet propozimi për lejimin e përmbarimit të kreditorit.

Debitori, nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e kreditorit.

Gjykata e Apelit të Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP) dhe gjeti se:

- ankesa e kreditorit është e pabazuar, për këto arsye:

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 05.03.2021, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbarimit në bazë të titullit ekzekutiv - vendimit të Inspektoratit të Punës, me numër 01Nr.06-91-1/2017 i datës 11.10.2017, i cili është i plotfuqishëm më i ekzekutueshëm nga data 18.12.2017, që ka të bëjë me pagesën e 3 pagave në emër të shpërblimit jubilar dhe kompensimin e 3 pagave përcjellëse me rastin e pensionimit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, ka nxjerrë aktvendimi CPC.nr.16/21 i datës 22.06.2022, me të cilin ka vendosur që të refuzohet propozimi për lejimin e përmbarimit të kreditorit, duke vendosur me shumë si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallë së parë ka theksuar se pas shqyrtimit të propozimit për përmbarim dhe analizimit të shkresave të lëndës, gjeti se propozimi për lejimin e përmbarimit duhet të refuzohet si i pabazuar për arsye se dokumenti përmbarues mbi bazën e të cilit kreditori e ka ushtruar propozimin për lejimin e përmbarimit është i pa përshtatshëm për përmbarim, sepse nga ky dokument përmbarimor nuk është e përcaktueshme shuma e detyrimit monetar që debitori duhet t'a përmbush ndaj kreditorit por, në mënyrë të përgjithësuar është obliguar është obliguar punëdhënësi të bëjë pagesën e shpërblimit jubilar, pas asnjë specifikim të shumave që duhet kompensuar. Gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se vendimi mbi të cilin është lejuara përmbarimi nuk i përmban këto elemente më decidivisht, nuk e përmban shumën që është e detyrueshme që ta përmbush debitori.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK, dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK, prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit Gjykata e Apelit, i konsideron të pabazuara dhe të paqëndrueshme, ngase nuk kanë bazë në prova konkrete.

Në rastin konkret pala kreditori me propozim për përmbarim i është referuar dokumentit përmbarimor - vendimi administrativ të inspektoratit të punës, prandaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ngase nga provat në shkresat

e lëndës ka gjetur se dokumenti përmbartimor nuk i plotëson kushtet ligjore për përmbartim, konform dispozitave ligjore në fuqi. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, në rastin konkret dokumenti përmbartimor është i papërshtatshëm për përmbartim edhe nga fakti se me nenin 27 të LPP, në mënyrë shprehimore është paraparë se *“dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në çiftë së në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Në bazë të nenit të sipërcituar del se kushtet në fjalë duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe se mungesa e vetëm njërit prej këtyre kushteve, e bënë dokumentin përkatës përmbartimor të papërshtatshëm për përmbartim. Në këtë drejtim Gjykata e Apelit gjen se pretendimet e kreditorit në lidhje me përshtatshmërinë e përmbartueshmërisë së dokumentit përmbartimor në formën dhe përmbajtjen e tij aktuale, janë të pabazuar dhe se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë kur e ka refuzuar propozimin e kreditorit për lejimin e përmbartimit.

Po ashtu, Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me asnjë nga pretendimet ankimore. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, drejtë janë zbatuar edhe dispozitat ligjore dhe gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se *“në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual”*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në pajtim me nenin 209 pika (b) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.265/2023 me datë 09.08.2024

Gjyqtari  
Adnan Konushevci